

**KONTRATË BINJAKËZIMI**

**Përkrahje për Statistikat**

**Kosovë**



**RAPORT MBI MISIONIN**

Përkrahje në zhvillimin e Regjistrimit Statistikor të Bizneseve (RSB) – Cilësia dhe mbulueshmëria e Regjistrimit të Bizneseve  
Komponenti nr 3.5.2.3

Misioni i udhëhequr nga  
Søren Netterstrøm, Statistikat e Danimarkës  
20-24 Prill 2015


*IPA 2012*

*Emri, adresa, emaili i autorit*

*Søren Netterstrøm*

*Statistics Denmark*

*Farverstræde 6*

*DK-4850 Stubbekøbing*

*Denmark*

*Tel: +45 5444 0475*

*Email: [sne@viv.dk](mailto:sne@viv.dk)*

## Përmbajtja

1. Komentet e përgjithshme .....	<b>Fejl! Bogmærke er ikke defineret.</b>
2. Statusi .....	4
3. Punë praktike .....	4
4. Çështjet e tjera .....	<b>Fejl! Bogmærke er ikke defineret.</b>
5. Plani kohor dhe misioni i radhës .....	7
Aneksi 1. Termat e Referencës .....	<b>Fejl! Bogmærke er ikke defineret.</b>
Aneksi 4. Procedurat (Janar 2015).....	<b>Fejl! Bogmærke er ikke defineret.</b>
Aneksi 5. Plani kohor përfshir planin e misionit .....	<b>Fejl! Bogmærke er ikke defineret.</b>
Aneksi 6. Modulet 11 .....	<b>Fejl! Bogmærke er ikke defineret.</b>
<a href="#">Aneksi 2. Personat e takuar</a> .....	<b>Fejl! Bogmærke er ikke defineret.</b>
<a href="#">Annex 3. Modeli i databazës</a> .....	<b>Fejl! Bogmærke er ikke defineret.</b>

## Shkurtesat

GSBPM	Modeli i përgjithshëm i procesit të prodhimit statistikor
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
ARBK	Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve Kosovare
NACE	Nomenklatura e veprimtarive ekonomike, rev.2
RSB	Regjistri Statistikor i Bizneseve
SBS	Statistikat Strukturore të Ndërmarrjeve
SIDA	Agjencia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar
SQL	Structured Query Language
STS	Statistikat Afatshkurtra
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
TeR	Termat e Referencës
TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar

## 1. Komentet e përgjithshme

Ky raport mbi misionin është përgatitur në kuadër të Projektit të Binjakëzimit „Përkrahje për Statistikat”. Ky është misioni pestë, që i kushtohet Regjistrimit Statistikor të Biznesit (RSB) në kuadër të komponentit 3 të projektit.

Qëllimi i këtij misioni ka qenë finalizimi i procedurave për azhurnimin e RSB-së me të dhëna nga burimet administrative dhe statistikore dhe përgatitja për misionin e radhës.

Konsulenti dëshiron të falënderojë të gjithë zyrtarët dhe personat e takuar, për mbështetjen dhe informacionet e vlefshme që kanë dhënë, gjë që ka lehtësuar shumë punën e tij gjatë qëndrimit në Kosovë.

**Këndvështrimet dhe vëzhgimet e paraqitura në këtë raport janë ato të konsulentëve dhe jo domosdoshmërisht përpunohen me këndvështrimet e BE-së, ASK-së apo Statistikave të Danimarkës.**

## 2. Gjendja aktuale

ASK tani ka marrë të dhëna nga ARBK-ja dhe ATK-ja (raportet tremujore dhe vjetore, si dhe të dhëna mujore sa i përket TVSh-së). Të dhënat lidhur me punëtorët janë marrë nga agjencioni TRUST.

Gjatë misionit të dhënat nga ATK-ja dhe TRUST janë futur në RSB. Janë futur kodet e aktivitetit nga 3 anketat statistikore.

Është tentuar të bëhet një azhurnim duke përdorur të dhënat nga ARBK. Megjithatë, për shkak të disa problemeve, që janë hasur, dhe mungesës së kohës, ky proces nuk është realizuar.

Për më tepër është vërejtur që të dhënat nga ARBK nuk kanë qenë të kompletuara, mungonte një numër i madh i njësive lokale ligjore. Ky problem duhet të zgjidhet para misionit të radhës, ku do të tentohet përsëri të azhurnohet RSB-ja, duke përdorur të dhënat nga ARBK-ja.

## 3. Analizimi i të dhënave nga ARBK

Të dhënat nga ARBK përmbajnë në disa raste kode jovalide të aktivitetit ose nuk kanë kod të aktivitetit fare. Para se të përdoren këto të dhëna, duhet të pastrohen kodet e aktivitetit si në vijim: Kodet jovalide dhe kodet e aktivitetit me vlerë ZERO janë vendosur si të panjohura (‘xxx’) nëse ato kode paraqesin aktivitetin kryesor.

Kodet jovalide dhe kodet e aktivitetit me vlerë ZERO janë fshirë, nëse paraqesin aktivitetin sekondar.

Duhet të verifikohet nëse secila njësi ligjore e ka një dhe vetëm një kod të aktivitetit kryesor.

Nëse nuk ka aktivitet kryesor, duhet të bëhet një me kod ‘xxx’ për të panjohur.

Nëse ka shumë, duhet të mbahet kodi më i ulët, të tjerët duhet të vendosen si aktivitete sekondare.

Kjo mund të aplikohet vetëm në vendosjen e kodit të aktiviteti për Ndërmarrje dhe të lihen kodet e aktivitetit për njësi ligjore siç kanë qenë në ARBK. Në të gjitha rastet kodet jovalide të aktivitetit duhet të shndërrohen në të panjohura, për të evituar problemet.

Ky pastrim i kodeve të aktivitetit është i nevojshëm në mënyrë që azhurnimi e RSB-së të funksionojë pa gabime.

Procedura për krijimin e transaksioneve nga ARBK-ja duhet të shqyrtohet më tej, për tu siguruar që nuk ka njësi që mungojnë (njësi ligjore ose lokale ligjore) në ARBK. Është supozuar që ARBK kurrë nuk i fshin njësitë, por vetëm shënon që kanë përfunduar.

## 5. Të dhënat nga ATK-ja

ASK ka pranuar informata të detajuara nga ATK-ja. Këtu përfshihen raportet tremujore, pasqyrat financiare vjetore dhe të dhënat mujore, sa i përket TVSH-së, kur është e përshtatshme.

Si rrjedhojë, Qarkullimi mund të merret prej cilitdo burim ose prej tre burimeve të lartpërmendura. Duhet të vendoset një procedurë për kalkulimin e qarkullimit për një vit. Nëse ka pasqyra financiare vjetore, qarkullimi merret prej tyre, përndryshe, nëse raportet janë tremujore, qarkullimi merret nga këto raporte dhe në fund përdoren të dhënat e TVSH-së. Ky qarkullim i kalkuluar ruhet në RSB në tabelën për qarkullim\_njesisë\_fiskale dhe pastaj përcillet në qarkullim\_ndërmarrjes.

Raportet nga ATK-ja merren në baza tremujore ku janë të përfshira të dhënat e vitit aktual dhe vitit të kaluar. Të dhënat që i përkasin tremujorëve dhe viteve të kaluara mund të jenë të rishikuara.

Procesi i krijimit të qarkullimit të kalkuluar është i përpiluar për vitin aktual dhe për vitin e kaluar, dhe të dhënat në të dyja tabelat e RSB-së zëvendësohen me të dhëna të reja. Duhet të theksohet që qarkullimi për vitin aktuale do të jetë vetëm për një pjesë të vitit.

Të gjitha të dhënat e pranuar nga ATK do të ruhen në RSB në një tabelë të re e cila është e lidhur me nivelin e ndërmarrjes.

Këto të dhëna kryesisht përdoren nga Llogaria Kombëtare. Duke i lidhur me ndërmarrjen mund të përforcohen me kod të aktivitetit, komunë (vendbanim) ose të përdoren për të analizuar në detaje disa ndërmarrje të mëdha nëse është e nevojshme.

## 6. Kodet e aktivitetit (duke përdorur të dhënat nga anketat).

Njësitë statistikore, Ndërmarrjet dhe Njësitë Ligjore do të plotësohen me të dhënat e marra gjatë anketave statistikore. Më i rëndësishmi është kodi i aktivitetit.

Kur krahasohet kodi i aktivitetit kryesor i njësive ligjore me kodin e aktivitetit të marrë nga Anketa e Regjistrimit Statistikor të Biznesit (ARSB), 25% e njësive kanë kode të ndryshëm të aktivitetit në anketë. Mund të supozohet që situatë e njejtë mund të jetë edhe për njësitë, që nuk mbulohen nga ARSB-ja.

Megjithatë, do të ishte shumë e lartë kostoja sikur të anketoheshin të gjitha njësitë e RSB-së, për të marrë kodet korrekte të aktivitetit. Mirëpo, kur anketohen njësitë, në ARSB, ASN, Statistika Afatshkurta, ose në ndonjë anketë tjetër, së paku kur anketohet njësia për herë të parë duhet bërë përpjekje për të verifikuar ose për të marrë kodin korrekt të aktivitetit kryesor për njësinë.

Burimi i kodit të aktivitetit regjistrohet në RSB. Kjo bëhet për të parandaluar zëvendësimet automatike të kodeve të marra përmes anketave, nëse kodi i aktivitetit në ARBK ndryshon. Kjo po ashtu mund të përdoret për të identifikuar njësitë, për të cilat është e nevojshme të verifikohen kodet e aktivitetit kur ato përzgjedhen për ndonjë anketë.

Kur azhurnohet RSB, burimi duhet të ndërrohet duke iu referuar në anketës përkatëse, edhe kur njësia ligjore e ka kodin e njejtë të aktivitetit nga ARBK-ja, pasi ky është indikator i cilësisë së kodit.

Shumica e njësive në RSB do të kenë vetëm një kod të aktivitetit. Megjithatë, për një numër të caktuar të njësive të mëdha, ndoshta nevojitet të shtohen më shumë kode të aktivitetit. Deri tani, ARSB është burimi i vetëm.

Në rast se ka më shumë se një kod të aktivitetit për ndërmarrjet, çdo kod i aktivitetit përfaqëson një njësi mbi llojin e aktivitetit (KAU). Duhet të shqyrtohet mundësia që të jepet një vlerësim në përqindje i qarkullimit total të ndërmarrjes, që vjen nga secili aktivitet. Kjo do të mundësonte përdorimin më të mirë të dhënave nga ATK (qarkullimi dhe të dhënat e tjera) kur përmbledhen sipas aktivitetit, duke ofruar kështu të dhëna më të mira për Llogaritë Kombëtare.

Rekomandohet që ASK të përcaktojë fizibilitetin e kësaj mundësie dhe të përcaktojë se kush do të jetë përgjegjës për të siguruar dhe azhurnuar këto të dhëna (Mund të jetë Statistikat e Biznesit ose Llogaritë Kombëtare).

## 7. Procedurat për azhurnim

Janë analizuar procedurat për azhurnimin, të krijuara deri tani, dhe është shfrytëzuar mundësia e për vazhdimin e trajnimit praktik për testimin dhe ndryshimin e procedurave, sipas nevojës.

Është parashikuar që gjatë misionit të ardhshëm do të jetë e mundur që për herë të parë të azhurnohet RSB-ja me të dhëna nga ARBK-ja, ATK-ja dhe Anketave.

Njëri nga rezultatet obligative të këtij komponenti është

- Rekomandimet për procedurat e reja për të siguruar azhurnimin e rrjedhshëm të RSB-së nga burimet në dispozicion.

Këto rekomandime janë dhënë në misionin e kaluar dhe tani po implementohen po ashtu.

Konsulentët janë të bindur, që kur të vendoset sistemi, azhurnimet nga ARBK-ja, ATK-ja, TRUST-it dhe burimet statistikore mund të bëhen në mënyrë më të rrjedhshme. Por, gjithmonë do të ketë raste (transaksione të papërfunduara) që do të kërkojnë intervenimin manual.

Megjithatë, supozohet që numri i këtyre rasteve do të jetë i vogël dhe shumica e tyre në lidhje me njësitë komplekse, ku rëndësia e cilësisë së lartë në RSB mund të justifikojë resurset që përdoren për këtë qëllim.

## 6. Mundësitë për përdoruesit

Është mbajtur një takim me përdoruesit e ardhshëm të RSB-së nga Statistikat e Bizneseve dhe Llogarive Kombëtare, duke analizuar shkurtimisht RSB-në.

Plani është që t'u mundësohet përdoruesve të nxjerrin ekstrakte të dhënash, sipas kriterëve të caktuara, nga RSB-ja duke përdorur tabela ekseli. Janë paraqitur disa shembuj edhe të nxjerrjes së të dhënave për njësi individuale duke plotësuar kriterë të caktuara, edhe të krijimit të të dhënave të përmbledhura mbi qarkullimin dhe punësimin nga të dhënat e ATK-së, sipas aktivitetit dhe/ose aspektit gjeografik. Pjesëmarrësve iu kërkuar të mendojnë edhe për nevoja të tjera, që mund të kenë, për nxjerrje të dhënash nga RSB-ja.

Gjatë misionit të ardhshëm është parashikuar të mbahet një ditë trajnimi në lidhje me këtë qëllim.

## 7. Një regjister i saktë i biznesit

Me zhvillimin e RSB-së, ASK do të ketë një Regjistër Statistikor të Biznesit të saktë, me njësitë, sipas rregulloreve të BE-së, në vend të njësive administrative, që janë përdorur deri më tani.

Ngritja më e rëndësishme e cilësisë është përdorimi i kodeve të aktivitetit nga anketat, ku njësitë për një kohë do të gjenerohen automatikisht, bazuar në të dhënat administrative.

Konsulentët dëshirojnë të theksojnë, që në momentin që kompletohet RSB (i plotësuar me të dhëna siç janë përshkruar më lart), duhet të përdoret si burim i vetëm në kuadër të ASK-së, nga anketat statistikore dhe Llogaritë Kombëtare, për të përmirësuar koherencën midis anketave.

## 8. Misioni i radhës.

Misioni i radhës, me Søren Netterstrøm, është caktuar të mbahet nga data 25 Maj 2015.

*Veprimet, që duhet të finalizohen para misionit të radhës*

<b>Veprimet</b>	<b>Personi përgjegjës</b>
Plotësimi i RSB me versionin e Marsit nga ARBK	Muhamet Kastrati
Plotësimi me kode të aktivitetit nga SBRS, ASN, dhe Stat.afatshkurta	Muhamet Kastrati
Plotësimi me të dhënat mbi taksat për Ndërmarrjet	Muhamet Kastrati

## Aneksi 1. Termat e Referencës



Projekti i Binjakëzimit i BE-së  
KS12 IB ST 01  
Përkrahje për Statistikat

### Termet e Referencës:

**Komponenti 3:** Statistikat e Biznesit

**Aktiviteti 3.5.2.3:** Përkrahje në zhvillimin e Regjistrimit Statistikor të Bizneseve (RSB) – Cilësia dhe mbulueshmëria e Regjistrimit të Bizneseve

### Orari:

**TeR –data e përgatitjes:** 27 Mars 2014

**Fillimi / fundi i aktivitetit:** 20-24 Prill 2015

**Koha e raportimit:** 1 Maj 2015



**Rezultatet obligative të komponentit:**

Rezultatet obligative	Intervenimi logjik	Standardet	Burimet e informacionit	Supozimet
<b>Rezultati obligativ 3.5.2</b>	<b>Përkrahje për përmirësimin e Regjistrisë Statistikore të Bizneseve (RSB)</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Raporti i misionit, që paraqet fushat më të rëndësishme të veprimit, për përmirësimin e regjistrisë të bizneseve, i publikuar në çebfaqen e projektit</li> <li>Afati kohor dhe harta rrugore për përmirësim, të zhvilluara</li> <li>Rekomandimet për procedurat e reja për të siguruar përditësimin e RSB-së nga burimet që janë në dispozicion</li> <li>Drafti i tabelës korresponduese midis NACE Rev 1.1 dhe NACE Rev 2., i përditësuar</li> <li>Tabela korresponduese midis NACE Rev 1.1 dhe NACE Rev 2, e finalizuar</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Raportet tremujore të Binjakëzimit</li> <li>Raportet e Misionit</li> <li>Harta rrugore</li> <li>Afatet kohore</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Kapaciteti i mjaftueshëm absorbimi</li> <li>Numër i vogël i stafit i involvuar në implementim</li> <li>Stafi punon në realizimin e detyrave, që lidhen me projektin, në mes të misioneve</li> <li>Termet e referencës, të përpiluara me kohe, që paraqesin në detaje detyrat, (inputi), rezultatet e pritura, pjesëmarrësit në aktivitetet dhe agjendën</li> </ul>

**Subjekti / qëllimi i aktivitetit: aktiviteti 3.5.2.3**

Ky mision është vazhdim i misionit të kaluar mbi RSB-në Mars të vitit 2015.

Pas përfundimit të misionit, duhet të definohen procedurat për azhurnimin e RSB-së nga burimet e jashtme dhe të brendshme.

Procedurat për azhurnimin, duke përdorur të dhëna nga ARBK-ja dhe ATK-j, duhet të finalizohen në mënyrë që të jetë e mundur të bëhet plotësimi i RSB-së me të dhënat nga këto burime.

Burimet e brendshme duhet të identifikohen dhe procedurat për përdorimin e këtyre burimeve duhet të definohen.

Është parashikuar të zhvillohet një mënyrë që do t'u mundësojë përdoruesve të RSB-së, sidomos divizionit të Llogarive Kombëtare, të kenë qasje në një pjesë të të dhënave të RSB-së, sipas kriterëve të caktuara, për njësi të vetme dhe njësi të ndërlidhura p.sh. një ndërmarrje dhe të gjitha njësitë ligjore, lokale dhe lokale ligjore të ndërlidhura. Kjo temë duhet të diskutohet me përdoruesit me qëllim të vendosjes së listës së prioritetëve.

Duhet të planifikohet një plani i ri kohor dhe të riorganizohet radha e detyrave të mbetura.

**Rezultatet e pritura të aktivitetit 3.5.2.3:**

Raporti i misionit – Përshkrimi i progresit të bërë nga misioni i kaluar.

Prioritetizimi i ri i azhurnuar i veprimeve të mundshme

Syqyerimet për Termet e referencës për aktivitetet e tjera në lidhje me RSB.

**Stafi i ASK-së:**

Z. Muhamet Kastrati, Menaxher i Databazës, [muhamet.kastrati@rks-gov.net](mailto:muhamet.kastrati@rks-gov.net)

**Ekipi i Projektit të Binjakëzimit i ASK-së:**

Udhëheqës i Projektit ne ASK, Z. Ilir T. Berisha, Drejtor i Statistikave Ekonomike dhe Llogarive Kombetare, [Ilir.T.Berisha@rks-gov.net](mailto:Ilir.T.Berisha@rks-gov.net)

Homologu i RTA, Znj. Teuta Zyberi, Zyrtare e Lartë për Marrëdhënie me Jashtë, [teuta.zyberi@rks-gov.net](mailto:teuta.zyberi@rks-gov.net)

**Ekspertët e vendeve anëtare**

Z. Søren Netterstrøm, Ekspert i Statistikave të Biznesit, Statistikat e Danimarkës, [sne@viv.dk](mailto:sne@viv.dk)

**Ekipi i Projektit të Binjakëzimit:**

Z. Per Knudsen, RTA, [pkn@dst.dk](mailto:pkn@dst.dk)

Znj. Nora Zogaj, RTA Asistente, [nzogaj@yahoo.com](mailto:nzogaj@yahoo.com)

**Përshkrimi i historikut për aktivitetin**

Ky mision është i bazuar mbi planin e përgatitur nga ekspertët e vendeve anëtare dhe eksperti i ASK-së gjatë misionit të fundit.

Gjatë misionit të kaluar është arritur në përfundimin që, meqenëse projekti është shtyrë deri në fillim të Marsit 2016, ende është e mundur të arrihet qëllimi i vendosur për këtë projekt.

Duhet të bëhet një riorganizim i radhës së aktiviteteve në këtë projekt. Në vend se të presim që aplikimi online të jetë gati para se të ngarkohet në RSB, konsiderohet e mundshme dhe e dobishme të plotësohet RSB-ja sa më shpejtë të jetë e mundur (deri në fund të Qershorit) me të dhëna nga ARBK-ja dhe anketat statistikore dhe të vendosen procedurat për përdoruesit, siç është përshkruar më lart, duke përdorur tabelat. Kjo do të ofrojë mundësinë për përdoruesve të përfitojnë në fazë më të hershme nga zhvillimi i regjistrimit statistikor të bizneseve.

Kjo ide është aprovuar. Por, pasi kjo u vendos në fund të misionit, nuk kishte kohë për përgatitjen e një plani të ri. Kjo do të bëhet gjatë misionit të radhës.

*Veprimet, që duhet të finalizohen para misionit të radhës*

<b>Veprimet</b>	<b>Personi përgjegjës</b>
SQL Procedurat për zhvillim të mëtejshëm të azhurnimeve	Muhamet Kastrati
Marrja dhe ngarkimi i të dhënave të para nga ASN, stat.afatshkurta dhe Anketës së Regjistrimit të Bizneseve.	Muhamet Kastrati

**Aktivitetet, që duhet të ndërmerren si përgatitje për misionin:**

- Të gjitha raportet e Komponentit 3 Statistikat e Biznesit mund t'i gjeni në [dst.dk/kosovo](http://dst.dk/kosovo)

**Aktivitetet e pritura janë:**

- Analizimi i aktiviteteve nga misioni i fundit
- Zhvillimi i mëtejshëm i databazës
- Diskutimi i mëtejshëm nëse prioritetizimi i ri i veprimeve është i mundshëm.

**Rezultatet e pritura:**

- Raporti i misionit – sipas modelit për raportim
- Plani i detajuar për aktivitetet tjera të kompletohet, sa i përket RSB-së në Kosovë nga ana e programit të binjakëzimit

## Aneksi 2. Personat e takuar

### Stafi i ASK-së:

Z. Muhamet Kastrati, Menaxher i Databazës, [muhamet.kastrati@rks-gov.net](mailto:muhamet.kastrati@rks-gov.net)

Z. Ismajl Sahiti, Shef i Divizionit, [ismail.sahiti@rks-gov.net](mailto:ismail.sahiti@rks-gov.net)

### Ekipi i Binjakëzimit i ASK-së:

Udhëheqës i Projektit Mr. Ilir T. Berisha, Drejtor i Statistikave Ekonomike dhe Llogaritë Kombëtare, [Ilir.T.Berisha@rks-gov.net](mailto:Ilir.T.Berisha@rks-gov.net)

### Ekspertët e vendeve anëtare

Z. Søren Netterstrøm, Ekspert i Statistikave të Biznesit, Statistikat e Danimarkës, [sne@viv.dk](mailto:sne@viv.dk)

### Ekipi i Projektit të Binjakëzimit:

Z. Per Knudsen, RTA, [pkn@dst.dk](mailto:pkn@dst.dk)

Znj. Nora Zogaj, RTA Asistente, [nzogaj@yahoo.com](mailto:nzogaj@yahoo.com)